




NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi “Bil Clinton” Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar “Bil Clinton” Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel. 038/526-070, 525-006 Fax: 038/526-159 Email: info@iber-lepenc.org

 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	013	Nr. Prot. Br. Prot.	1562
Nr. ifaqave Broj stranica No. pages	80	Data: Datum: Date:	05.07.22
PRISHTINE A		NO.1	

Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Vendimi : (III)

Miratohet Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit
për vitin 2021.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	U.D Kryeshef Ekzekutiv	Kryesues i B.D
Nënshkrimi	Januz Kabashi	Bajram Mustafa
Data:04.07.2022		




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NPH "IBËR - LEPENC" SH.A PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a (Ibër-Lepenci sh.a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a deri me 31 dhjetor 2021, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- B1 Ndërmarrja nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive fikse që nga viti 2007, për të siguruar se vlera e tyre kontabël nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë pas rivlerësimit në fund të periudhës raportuese.
- A1 Ndërmarrja nuk ka bërë korrigjimin e rezervës së rivlerësimit të pasurive të realizuar në vitin 2007 në vlerë 162,424,909€ në baza të rregullta, si rezultat i zhvlerësimit për pjesën e vlerës së rritur pas rivlerësimit, duke rezultuar kështu në prezantimin jo të saktë të vlerës së rezervës së rivlerësimit si dhe shpenzimeve të zhvlerësimit në pasqyrat financiare të vitit 2021.
- A2 Pasuritë e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar janë nënvlerësuar për 138,663€, pasi që ndërmarrja nuk ka regjistruar plotësisht vlerën e pasurive të financuar nga kredia, duke përfshirë edhe avansin dhe pjesën e ndalur për garancion por vetëm pjesën e paguar. Rrjedhimisht, parapagimi është mbivlerësuar për 47,604€ si dhe obligimet janë nënvlerësuar për 91,059€.
- A3 Gjatë vitit 2021, NP "Ibër Lepenci" nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjeve kontabël me të dhënat e konsumatorëve. Si rezultat i kësaj, në tri raste shuma e borxhit e konfirmuar nëpërmjet konfirmimeve të jashtme ishte më e ulët për 17,098€ se shuma e borxhit në shënime kontabël. Për më tepër, ndërmarrja ka prezantuar 15,408€ provizionim për vlerën e lartpërmendur, por të njëjtën nuk kanë arritur ta mbështesin me dëshmitë e duhura.
- A4 Testet tona tregojnë se shpenzimet e sigurimit shëndetësor të punonjësve të kompanisë fillimisht janë regjistruar si parapagim e më pas janë zbritur nëpër muaj si shpenzime të ndara nëpër njësi në vlerë totale vjetore 94,483€. Pra këto shpenzime nuk janë përfshirë në të ardhurat bruto nga pagat e punëtorëve sipas kërkesës së ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale.
- A5 Çështjet materiale të identifikuar më lartë lidhur me rezervën e rivlerësimit, pasuritë, parapagimet, obligimet, shpenzimet e pagave dhe shpenzimet e zhvlerësimit, të cilat kanë ndikim në gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe në flukset monetare, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë dhe të drejtë, të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, në pasqyrën e rrjedhës së parave, si dhe në prezantimin e shënimeve shpjeguese.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A6 Ndërmarrja nuk ka të përcaktuar në rregullore hapat e kontrollit të brendshëm me qëllim të mbulimit të rreziqeve nga gabimet dhe keqpërdorimet eventuale, sa i përket procesimit të të gjitha llojeve të shpenzimeve, procesimit të pagave të punonjësve, si dhe menaxhimit të të hyrave.
- A7 Ndërmarrja nuk ka bërë inventarizimin e të gjitha pasurive, si dhe harmonizimin e regjistrit të pasurive me raportin e komisionit të inventarizimit në fund të vitit, i cili ka pamundësuar vërtetimin e ekzistencës dhe vlerës së saktë të pasurive.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i NPH "Ibër - Lepenc" sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e NPH "Ibër - Lepenc" sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime. Prej tyre, 11 janë rekomandime të reja dhe një (1) është i përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes

Gjetja

Sipas SNK 16 Aktivitet afatgjatë materiale - rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej, nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Procesin e vlerësimit të pasurive, për herë të fundit Kompania e kishte realizuar në vitin 2007. Si rezultat i kësaj në regjistrin kontabël të pasurive figurojnë 1,301 të tilla me kosto historike në shumën 9,131,982€, e që janë të zhvlerësuara në tërësi dhe vlera neto e tyre në libra ishte zero. Për më tepër, në regjistrin e pasurive gjenden edhe 47 pasuri të cilat nuk kanë vlerë blerëse në mungesë të dëshmive. Këto pasuri janë ende aktive dhe për to nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre, ashtu siç nuk ishte bërë edhe për pasuritë e tjera.

Sipas konfirmimeve zyrtare, ndërmarrja ka konsideruar se vlerësimi i pasurive duhet të iniciohet dhe të bëhet nga Qeveria e Kosovës si pronar i pasurive të ndërmarrjes.

Ndikimi

Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre në datën e raportimit të pasqyrave financiare, të jetë me vlera materialisht të ndryshme nga vlera e drejtë e tyre.

Rekomandimi B1

Bordi Drejtues të sigurojë që në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të bëhet rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes, me qëllim të prezantimit të vlerës së drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Prezantimi jo i saktë i Rezervës së Rivlerësimit

Gjetja

SNK 16 - Aktivet afatgjata materiale: - paragrafi 39, përcakton që, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet tek kapitalet e veta me titullin tepricë rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për atë që kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje. Po ashtu - paragrafi 40, përcakton, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për atë që kjo mbulon çdo tepricë kreditore ekzistuese në tepricën e rivlerësimit në lidhje me atë aktiv. Rënia që njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, zvogëlon shumën e akumuluar në kapital në zërin, tepricë nga rivlerësimi.

Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare ishte 162,424,909€ e cila është si rezultati i rritjes së aktiveve nga rivlerësimi në vitin 2007. Kjo shumë që nga viti 2007 nuk është korigjuar në baza të rregullta, si rezultat i zhvlerësimit për pjesën e vlerës së rritur pas rivlerësimit. Si pasojë e kësaj, vlera e rezervës së rivlerësimit si dhe shpenzimet e zhvlerësimit nuk paraqesin gjendjen e tyre të saktë në pasqyrat financiare.

Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, mos korigjimi i rezervës së rivlerësimit që nga rivlerësimi i fundit, ka ndodhur në mungesë të një analize të thellë të trajtimit të pjesës së rezervës së rivlerësimit sipas kërkesave të standardeve.

Ndikimi

Mos korigjimi i rezervës së rivlerësimit si rezultat i zhvlerësimit ndër vite, ka rezultuar në mos prezantimin e saktë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, korigjimin e rezervës së rivlerësimit si rezultat i zhvlerësimit të akumuluar sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos prezantimi i saktë i pasurive të financuara nga kredia

Gjetja

Sipas SNK 16 Aktivet afatgjata materiale - rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej, nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Pasuritë e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar janë nënvlerësuar për 138,663€, pasi që ndërmarrja nuk ka regjistruar plotësisht vlerën e pasurive të financuara nga kredia, duke përfshirë edhe avansin dhe pjesën e ndalur për garancion por vetëm pjesën e paguar. Rrjedhimisht, parapagimi është mbivlerësuar për 47,604€ si dhe obligimet janë nënvlerësuar për 91,059€.

Sipas përgjegjësve të ndërmarrjes, mos regjistrimet adekuate të pasurive, e rrjedhimisht edhe parapagimeve dhe obligimeve kanë ndodhur në mungesë të komunikimit të informacioneve në mes të departamenteve brenda ndërmarrjes.

Ndikimi Raportimi jo i saktë i pasurive, parapagimeve si dhe obligimeve, rezulton në prezantimin jo të saktë dhe të drejtë të pasqyrave financiare vjetore të ndërmarrjes.

Rekomandimi A2 Bordi Drejtues të siguroj korrjimin e regjistrimit jo të duhur të pasurive të ndërmarrjes, e rrjedhimisht edhe të parapagimeve dhe obligimeve, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mospërputhje në mes të shënimeve kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe letër konfirmimeve

Gjetja Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit, i cili duhet të barazohet me librat kontabël. Gjithashtu sipas Kornizës konceptuale, paragrafi 4.44, specifikon se një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e këtij aktivi mund të matet me besueshmëri.

Gjatë vitit 2021, NP "Ibër Lepenci" nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjeve kontabël me të dhënat e konsumatorëve. Si rezultat i kësaj, në tri raste shuma e borxhit e konfirmuar nëpërmjet konfirmimeve të jashtme ishte më e ulët për 17,098€ se shuma e borxhit në shënimet kontabël. Për më tepër në kuadër të zërit të llogarive të arkëtueshme dhe shpalosjeve të tyre, ndërmarrja ka prezantuar provizionimin prej 15,408€ për vlerën e lartpërmendur, por të njëjtën nuk ka arritur të mbështes me dëshmi përkatëse.

Sipas konfirmimeve nga zyrtarët, këto diferenca janë si rezultat i faturimeve të gabuara të cilat janë kontestuar edhe nga blerësit, për të cilat në kaluarën është bërë provizionimi, por pa dëshmi mbështetëse, dhe që nuk janë korrigjuar plotësisht në shënimet kontabël.

Ndikimi Mos harmonizimi periodik i të dhënave të ndërmarrjes dhe klientëve të saj dhe mos korrigjimi i plotë i tyre, ndikon në keq deklarimin e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe klientëve të saj në baza periodike, në mënyrë që të konfirmohet vlera saktë e llogarive para prezantimit të tyre në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit të punëtorëve në të ardhurat bruto

Gjetja Sipas Ligjit Nr.05/L-028 për tatimin në të ardhura personale, neni 9, në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen: bonuset, provizionet, mëditjet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës.

Testet tona tregojnë se shpenzimet e sigurimit shëndetësor të punonjësve të kompanisë fillimisht janë regjistruar si parapagim e më pas janë zbritur nëpër muaj si shpenzime të ndara nëpër njësi në vlerë totale vjetore 94,483€. Pra këto shpenzime nuk janë përfshirë në të ardhurat bruto nga pagat e punëtorëve sipas kërkesës së ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale.

Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit të punëtorëve në të ardhurat bruto, ka ndodhur për shkak të mungesës së njohurive mbi trajtimin e duhur të këtyre pagesave.

Ndikimi Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit shëndetësor të punëtorëve në të ardhurat bruto me qëllim të ndaljes së tatimit në të ardhurat personale, ka ndikuar në mos ndaljen e tatimit si dhe në prezantimin jo të saktë të fondit të pagave.

Rekomandimi A4 Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që në të ardhurat personale bruto të përfshihen të gjitha përfitimet e punonjësve sipas kërkesës ligjore në mënyrë që të aplikohet tatimi në vlerën e plotë të ardhurave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos prezantim i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë, pasqyrës së ndryshimit në ekuitet, si dhe shënimeve shpjeguese

Gjetja Sipas SNK 1- një njësi ekonomike duhet të përgatit pakon e plotë të pasqyrave financiare e cila ka për qëllim të përgjithshëm të sigurojë informacione lidhur me pozicionin financiar, performacën financiare, fluksin monetar, si dhe shënimet shpjeguese të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare vjetore.

Çështjet materiale të identifikuar më lartë lidhur me rezervën e rivlerësimit, pasuritë, parapagimet, obligimet, shpenzimet e pagave dhe shpenzimet e zhvlerësimit, të cilat kanë ndikim në gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe në flukset monetare, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë dhe të drejtë, të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, në pasqyrën e rrjedhës së parave, si dhe në prezantimin e shënimeve shpjeguese.

Mos prezantimi i saktë i pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet, pasqyrës së rrjedhës së parave si dhe shënimeve shpjeguese, ka ndodhur si rezultat i mos prezantimit të zërave individual sipas kërkesave të standardeve.

Ndikimi Mos prezantimet e sakta të zërave individual të pasqyrave financiare, rrjedhimisht kanë ndikuar edhe në mos prezantimin e saktë të pasqyrave të tjera financiare si tërësi.

Rekomandimi A5 Bordi i Drejtorëve të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet, pasqyrës së rrjedhës së parave, si dhe shënimeve shpjeguese dhe të marrë veprimet nevojshme korrigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A6 - Mos dizajnimi i kontrolleve të duhura në rregulloret për menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve dhe procesimit të pagave

Gjetja Sipas Nenit 34.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike "Të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare" si dhe Nenit 7.2 të Statutit të Ndërmarrjes Publike NH "Iber Lepenci" Prishtinë (Sh.A.), "kompania duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë". Rregulloret miratohen, ndryshohen ose revokohen nga aksionarët ose Bordi i Drejtorëve.

Ndërmarrja nuk ka të përcaktuar në rregullore hapat e kontrollit të brendshëm me qëllim të mbulimit të rreziqeve nga gabimet dhe keqpërdorimet eventuale, lidhur me procesimin e të gjitha llojeve të shpenzimeve, procesimit të pagave të punonjësve, si dhe menaxhimit të të hyrave.

Kjo ka ndodhur për shkak se, Kompania e kishte konsideruar si të mjaftueshme rregulloren për Kontabilitet dhe Financa, në përmbajtje të së cilës është e rregulluar mënyra e organizimit të punëve të kontabilitetit dhe afarizmit financiar, por jo edhe procedurat e kontrollit për menaxhimin e tyre.

Ndikimi Mos përcaktimi i hapave të kontrollit në rregulloret për menaxhimin e proceseve afariste brenda kompanisë, krijon parakushte për parregullsi në rrjedhën e dokumentacionit kontabël dhe rrit mundësitë për gabime apo keqpërdorime financiare.

Rekomandimi A6 Bordi i Drejtorëve të sigurojë hartimin e rregulloreve për menaxhimin e proceseve afariste ku do të përcaktohen qartë procedurat dhe kontrollet e brendshme të cilat do të ndihmojnë në menaxhimin e rreziqeve nga gabimet apo keqpërdorimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mos inventarizimi i të gjitha pasurive si dhe mos harmonizimi me librat kontabël

Gjetja Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare dhe duhet të barazohet me librat kontabël.

Gjatë auditimit, testimet e 70 mostrave tregojnë se për 64 pasuri në vlerë prej 97,425,025€ ndërmarrja nuk ka pasur dëshmi se ka bërë inventarizimin e tyre, së paku një herë gjatë vitit 2021, për të verifikuar ekzistencën si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre. Për më tepër, ndërmarrja nuk ka bërë gjithashtu edhe harmonizimin e tërësishëm të raportit të inventarizimit të pasurive me librat kontabël.

Sipas konfirmimit të zyrtarëve, mos inventarizimi dhe harmonizimi i ndërtesave kishte ndodhur për shkak të pamundësisë së identifikimit se tek cilët përgjegjës të ngarkohen ndërtesat si dhe vonesave në procesin e inventarizimit vjetor.

- Ndikimi** Mos inventarizimi i të gjitha pasurive, si dhe mos harmonizimi i gjendjes së tyre faktike me regjistrat kontabël, zvogëlon sigurinë e ekzistencës së tyre në ditën e inventarizimit. Kjo mund të rezultojë në prezantimin dhe shpalosje jo të duhura në pasqyra financiare.
- Rekomandimi A7** Bordi i Drejtorëve të sigurojë që procesi i inventarizimit të bëhet në mënyrë të rregullt dhe para dorëzimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që rezultatet e regjistrimeve të fundvitit të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe diferencat eventuale të reflektohen edhe në pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A8 - Vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare

Gjetja Neni 31.3 i Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton: "Brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmëria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e shih të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor (i) Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe (ii), sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit (eve) Komunal të Aksionarëve. Bordi i NP-së po ashtu do të publikojë raportet vjetore në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP".

Kompania nuk ka finalizuar pasqyrat financiare për vitin 2021, deri me datën 21.03.2022, të cilat gjithashtu nuk janë aprovuar nga Bordi Drejtues në mungesë të emërimit të tyre nga aksionarët, edhe përkundër kërkesave ligjore që të njëjtat të jenë të nënshkruara dhe aprovuara me datë 15 mars 2022.

Mos aprovimi i pasqyrave financiare ka ndodhur si rezultat i mos emërimit të bordit nga aksionari.

Ndikimi Mos hartimi, aprovimi si dhe publikimi me kohë i pasqyrave financiare, ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe mos informimin e shfrytëzuesve të pasqyrave financiare në afatin e paraparë kohor.

Rekomandimi A8 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e paracaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e realizuara të pagave për vitin 2021 ishin 3,571,866€. Më 31 dhjetor 2021, Kompania ka pasur gjithsej 306 të punësuar (në vitin 2020: 309 të punësuar). Gjatë vitit ishin plotësuar 16 pozita me punonjës të rinj si dhe zëvendësimin e punëtorëve që janë pensionuar gjatë vitit. Nga kjo fushë kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 110,787€ sipas pagave bruto si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A9 - Sistematizimi i punonjësve të kompanisë sipas rregullores të pa aprovuar nga Bordi i Drejtorëve

Gjetja

Sipas Nenit 34.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike "Të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare" si dhe Nenit 7.2 të Statutit të Ndërmarrjes Publike NH "Ibër Lepenci" Prishtinë (Sh.A.), "kompania duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë". Rregulloret miratohen, ndryshohen ose revokohen nga aksionarët ose Bordi i Drejtorëve.

Kompania që nga viti 2011 kishte rregulloren e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës. Në këtë rregullore kompania kishte të përcaktuar emërtimin e vendeve të punës, detyrat dhe përgjegjësit e punës si dhe niveli i pagesës për të gjitha pozitat e punës të shprehur në poena. Kompania asnjëherë nuk kishte plotësuar/ndryshuar këtë rregullore.

Në fund të vitit 2019, Kryeshefi Ekzekutiv në bashkëpunim me menaxhmentin kishin ndryshuar/plotësuar këtë rregullore ku edhe i kanë paraparë shuarjen, riemërimin dhe shtimin e disa pozitave tjera sipas nevojave të kompanisë. Tutje, kompania në fillim të vitit 2020 ka bërë ndryshimet e kontratave të punonjësve sipas pozitave dhe përcaktimin e pagave sipas kësaj rregullore, e cila nuk ishte aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Mos aprovimi i rregullores mbi sistematizimin e pagave ka rezultuar për shkak të pezullimit të ligjit të pagave dhe ndrrimit të shpeshtë të Bordeve drejtuese.

Ndikimi

Mos aprovimi i rregullores mbi sistematizimin e pagave mund të rezultojë në mos trajtim të barabartë të punëtorëve në pozita dhe përgjegjësi të njëjta si dhe pagesën e pagave jo konform pozitës së përcaktuar.

Rekomandimi A9

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se është aprovuar një rregullore/politikë për sistematizimin e punëtorëve të kompanisë në përputhje me strukturën organizative dhe se kompensimi i pagave bëhet konform rregulloreve të miratuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një Zyrtar të Auditimit. NJAB kishte përgatitur planin vjetor ku kishte planifikuar pesë (5) auditime, prej të cilave kishte realizuar katër (4), si dhe dy (2) auditime me kërkesë të Komitetit të Auditimit. Komiteti i auditimit kishte mbajtur gjashtë (6) takime dhe kishte shqyrtuar raportet e NJAB.

Çështja A10 - Staf jo i mjaftueshëm në Njësinë e Auditimit të Brendshëm

- Gjetja** Sipas Standardeve Ndërkombëtare dhe Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm 1300, 1310, 1311, Drejtuesi i Auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguridhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, përmes vlerësimeve të brendshme të cilat përfshijnë: monitorime të vazhdueshme të ecurisë së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, si dhe përmes vetëvlerësimeve periodike ose vlerësimeve nga personat të tjerë brenda organizatës, me njohuri të mjaftueshme në praktikën e auditimit të brendshëm.
- Funksioni i auditimit të brendshëm në kompani ushtrohet vetëm nga një zyrtar i cili kryen auditimet dhe bënë rishikimin e tyre, që pamundëson sigurimin e një programi efikas të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve audituese. Për më tepër, gjatë vitit 2021 ndërmarrja ka paraparë me plan të biznesit plotësimin edhe me dy punëtorë shtesë, por që plotësimi i stafit nuk është bërë, e gjithashtu pa një arsytim gjatë rishikimit të planit nuk është paraparë plotësimi me staf shtesë.
- Sipas Zyrtarit Kryesor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm edhe përkundër planifikimit për punëtorë shtesë në Planin fillestarë të Biznesit nuk është inicuar procedura për shpallje të konkursit.
- Ndikimi** Kryerja e aktiviteteve si dhe rishikimi i të njëjtave nga një zyrtar i vetëm pamundëson dhënien e sigurisë si dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve audituese.
- Rekomandimi A10** Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Auditimit të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm të krijojë një program efikas të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve të brendshme përmes rritjes së stafit në këtë njësi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Mungesa e planifikimit të angazhimit dhe programeve të punës së auditimit

- Gjetja** Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm 2200 dhe 2240, parashohin që auditorët e brendshëm duhet të hartojnë dhe dokumentojnë një plan për çdo angazhim, duke përfshirë edhe objektivat, fushëveprimin, qëllimin, afatet kohore, dhe ndarjen e burimeve të angazhimit. Po ashtu duhet të zhvillojnë dhe dokumentojnë programe të punës të cilat arrijnë objektivat e angazhimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2021 nuk kishte hartuar plane për angazhim dhe programe të punës së angazhimit, siç kërkohet me standarde.

Sipas NjAB, shkak i mos hartimit të planit dhe programeve të auditimit ishte fakti se një kërkesë e tillë nuk ishte konsideruar shumë relevante.

Ndikimi

Mungesa e planeve dhe programeve të angazhimit, rrit rrezikun për mos arritje të objektivave të angazhimeve si dhe mos identifikimit, analizimit, vlerësimit dhe dokumentimit të informatave në raportet e auditimit.

Rekomandimi A11

Bordi Drejtues dhe Komiteti i auditimit të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm për çdo angazhim të auditimit të hartoj dhe dokumentoj plan dhe programe të punës së angazhimit sipas kërkesave të SNPPAB -ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të NPH "Ibër-Lepenc" ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime kryesore. Raporti i auditimit ishte kryer nga një kompani e jashtme e auditimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, ishin zbatuar gjashtë (6) nga rekomandimet e vitit të kaluar, ndërsa një nuk ishte zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën vijuese.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2021

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmara	Statusi
1.	Llogaritë e arkëtueshme	Ne i rekomandojmë Menaxhmentit të zhvillojë dhe zbatojë një model adekuat të njohjes dhe matjes së provizionimeve të humbjes nga të arkëtueshmet, sipas kërkesave të SNRF 9 - Instrumentet Financiare.	Ndërmarrja ka ndërmarrë masat për inkasimin e borxheve përmes procedurës përbarimore për klientin i cili është në vonesë, sipas kërkesave të rregullores për provizionimin e llogarive të arkëtueshme.	I zbatuar
2.	Pasuritë afatgjata	Ne rekomandojmë që Menaxhmenti i Kompanisë të bëjë vlerësimin e rregullt të vlerës së rikuperueshme të këtyre pasurive në mënyrë që të identifikojë zhvlerësimin e mundshëm. Vlerësime të tilla duhet të bazohen në kërkesat e standardit përkatës SNK 36: Zhvlerësimi, si dhe duke marrë parasysh specifikat e industrisë.	Ndërmarrja nuk ka kryer rivlerësimin e pasurive të ndërmarrjes.	Nuk është adresuar
3.	Të hyrat	Ne rekomandojmë që Kompania të marrë në konsideratë azhurnimin / rinovimin e sistemit të saj të faturimit, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e rritura për integrimin e të dhënave dhe departamenteve organizative.	Ndërmarrja ka ndërmarrë masat.	I zbatuar
4.	Shpenzimet operative	Ne i rekomandojmë kompanisë të forcojë mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit duke marrë parasysh politikat dhe procedurat e saj, si dhe mjedisin rregullator.	Ndërmarrja ka ndërmarrë masat.	I zbatuar
5.	Shpenzimet e pagave	Ne rekomandojmë që Kompania të përmirësojë kontrollet e vendosura gjatë procesit të llogaritjes dhe njohjes së shpenzimeve të pagave të punonjësve.	Ndërmarrja ka ndërmarrë masat.	I zbatuar
6.	Shpenzimet e pagave	Menaxhmenti dhe pronari duhet të ndërnarrin të gjitha masat për të siguruar Bordin e Drejtoreve plotësisht funksional dhe efektiv.	Ndërmarrja ka ndërmarrë masat.	I zbatuar
7.	Shpenzimet e pagave	Ne rekomandojmë që Kompania të plotësojë vendet e lira të punës për të gjitha pozicionet kyçe të menaxhimit, përfshirë ZKF-në.	Ndërmarrja ka ndërmarrë masat.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Xhemile Berisha - Hoti, Udhëheqëse e ekipit



Vlora Duraku, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



IBÉR-LEPENC™

NOËRMARRIJA HIDROEKONOMIKE "IBÉR-LEPENC" S.P.A. SHIPTIMISHTË - MOŠTINA

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBÉR - LEPENC" J.S.C.

VOĐUŠTVO PREDUZEĆA "IBÉR - LEPENC" D.D.

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren e Kombëtare të Auditimit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
15.03.2022			
Emri i Klientit	Emri i Auditorit	Qëllimi	Tipi i Raportit
IBÉR-LEPENC	Zyra Kombëtare e Auditimit	Revizimi	Financiar
05	47	1/65	1

Fë nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a. për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Januz Kabashi

U.D. Kryeshef Ekzekutiv

Data: 10 qershor 2022



Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIAR

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha shumat në Euro)



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Përmbajtja:

	Faqe:
Pasqyra e pozitës financiare	2
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet e pasqyrave financiare	7

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIAR

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat në Euro)

NH IBËR - LEPENC SH.A.

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

<u>Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor</u>	<u>Shënim</u>	<u>2021</u>	<u>2020</u>
		<u>(në Euro)</u>	<u>(në Euro)</u>
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtëra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	3,990,631	3,277,121
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	1,540,546	1,805,935
Stoqet	8	1,263,639	1,259,978
Pasuritë tjera afatshkurtëra-Parapagimet	9	590,821	547,649
Gjithsejt pasuritë afatshkurtëra		7,385,637	6,890,683
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	10	101,199,222	105,506,650
Pasuria e paprekshme	11	29,449	0
Investimet në vijim	12	3,514,644	2,726,284
Gjithsej pasuritë afatgjata		104,743,315	108,232,934
GJITHSEJ PASURITË		112,128,952	115,123,617
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtëra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	13	562,184	794,517
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	14	726,000	363,000
Tatimet e pagueshme aktuale	15	37,325	17,095
Të hyrat e shtyra nga përmbarimi	16	652	29,136
Të hyrat e shtyra nga donacionet	17	1,420,373	1,446,981
Perfitimet e punonjesve të pagueshme	18	23,632	23,132
Gjithsej detyrimet afatshkurtëra		2,407,166	2,673,861
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	19	3,249,712	3,378,969
Gjithsej detyrimet afatgjata		3,612,712	3,378,969

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIAR

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat në Euro)

EKUITETI			
Kapitali aksionar	20	25,000	25,000
Humbjet e akumuluar		(53,379,122)	(49,255,874)
Humbjet e vitit		(2,961,713)	(4,123,248)
Rezervat tjera		162,424,909	162,424,909
Gjithse ekuiteti		106,109,074	109,070,787
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		112,128,952	115,123,617

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim më 31 mars 2022 nga Menaxhmenti i kompanisë dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

U.D. Kryeshf Ekzekutiv
Januz Kabashi

Zyrtar Kryesor Financiar
Arvita Zyferi-Hashani



NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIAR

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat në Euro)

PASQYRA E FITIMIT/HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021

	Shënimet	31 Dhjetor 2021 (në Euro)	31 Dhjetor 2020 (në Euro)
Të hyrat nga aktivitetet	21	6,247,122	4,491,704
Të hyrat tjera	22	124,968	88,297
Fitimi/Humbja bruto		6,372,090	4,580,001
Shpenzimet e zhvleresimit	10/12	4,632,955	4,620,435
Shpenzimet e personelit	23	3,571,866	3,237,827
Shpenzimet administrative	24	133,278	206,098
Shpenzimet operative	25	468,733	397,444
Shpenzimet e taksave	26	476,481	241,445
Fitimi/(Humbja) operativ-e		(2,911,223)	(4,123,248)
Shpenzimet e Interesit	27	50,490	
Fitimi/(Humbja) para tatimit		(2,961,713)	(4,123,248)
Shpenzimet e tatimit në fitim			
Fitimi/(Humbja) l/e vitit		(2,961,713)	(4,123,248)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		(2,961,713)	(4,123,248)
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit			

Humbja gjithëpërfshirëse e cila përcjelllet nga periudhat paraparke është për shkak të zhvlerësimit të lartë gjatë viteve. Shpenzimi i zhvlerësimit paraqet një zë jo-monetar sa i përket rrjedhjeve të parasë, por që ndikon drejtëpërdrejtë në rezultatin e fundivitetit.

NH IBËR LEPENC SH.A.**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIAR**

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha shumat në Euro)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUTITET PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2021
(Vlerat e shprehura në euro)

	Kapitali aksionar €	Fitimet e mbajtura €	Rezervat tjera €	Gjithsej €
Gjendja me 01 Janar 2020	<u>25,000</u>	<u>(49,255,874)</u>	<u>162,424,909</u>	<u>113,194,035</u>
Fitimi/(humbja) i/e vitit		(4,123,248)		(4,123,248)
Diferencat nga përkthimet valutore				
Dividendat				
Deponimet e kapitalit shtesë Ndarja e rezervave				
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	<u>25,000</u>	<u>(53,379,122)</u>	<u>162,424,909</u>	<u>109,070,787</u>
Fitimi/(humbja) i/e vitit		(2,961,713)		(2,961,713)
Diferencat nga përkthimet valutore				
Dividendat				
Deponimet e kapitalit shtesë Ndarja e rezervave				
Gjendja me 31 Dhjetor 2021	<u>25000</u>	<u>(56,340,835)</u>	<u>162,424,909</u>	<u>106,109,074</u>

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIAR

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumtat në Euro)

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

(Vlerat e shprehura në euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2021	2020
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	Shënimet		
Fitimi (humbja) neto e vitit		-2,961,713	-4,123,248
<i>Të rregulluara për:</i>			
Zhvlerësimi	10/12	4,632,955	4,620,435
Shpenzimet e interesit		50,490	
Fitimi nga shitja e pasurive fikse			-29,882
Fitimi (humbja) para interesit, tatimit dhe zhvlerësimit		1,721,732	467,305
Lëvizjet në kapitalin qarkullues			
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	7/9	222,217	-699,369
(Rritja)/zvogëlimi në stoqe	8	-3,661	-92,433
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	13,14,15	-211,604	72,382
Të hyrat e shtyera nga përmbarimi	16	-55,092	
Interesi i paguar	27	-50,490	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)		1,623,102	-252,115
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurise se paprekshme	10/11	-1,163,605	161,466
Shitjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	10/11	20,270	29,882
Investimet tjera në pronë, impiante dhe pajisje			-2,535,966
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)		-1,143,335	-2,667,550
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Të hyrat e shtyera nga donacionet	17		-15,316
Huamarrja	12	233,743	3,242,338
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)		233,743	3,227,022
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalentët e parasë (I + II + III)		713,510	307,357
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	6	3,277,121	2,969,764
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (IV + V)		3,990,631	3,277,121

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

N.H "Ibër-Lepenc" SH.A. është konstituar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës të këtij sistemi shumë funksional. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga UNMIK-u. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore. Në vitin 2007 në "Ibër Lepenc" ka përfunduar procesi i korporatizimit me të cilin është kryer edhe procesi i vlerësimit të aseteve dhe kështu nga data 1 janar 2008 ndërmarrja është regjistruar si shoqëri aksionare me emrin NH "Ibër Lepenc" – Sh.A. Prishtinë. Në ndërkohë, me kërkesë të Njesisë për Politika dhe Monitorin të Ndërmarrjeve Publike, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74 të datës 14.07.2009 dhe Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1 të datës 30.09.2009, më 22.10.2009, janë kryer ndryshimet në statutin e ndërmarrjes sipas të cilave është shuar ish Ndërmarrja Holding dhe është sqaruar se NH "Ibër-Lepenc" SH.A. është trashëgimtare e ish-Ndërmarrjes Publike dhe ish-Ndërmarrjes Holding. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ndërmarrja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka kompetenca ekzekutive e që njëherit është edhe zyrtari më i lartë në ndërmarrje. Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të rëndësishme të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes.

Veprimtaria kryesore e kompanisë është furnizimi me ujë të patrajtuar për qëllime të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, për kompanitë rajonale të ujësjellësve, për shfrytëzuesit industrial dhe gjeneron energji elektrike nga hidrocentrali në Ujman.

Numri mesatar i të punësuarve për vitin 2021 është 303.

Selia qendrore e ndërmarrjes është në Prishtinë, Sheshi "Bill Clinton", nr.13, Kosovë.

2. BAZA E PËRGATITJES

(a) Deklaratë e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me koston historike e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në vlerën e rivlerësuar.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Valuta raportuese në evidencën e NH "Ibër-Lepenc" SH.A. dhe pasqyrat financiare është valuta Euro (€). Transakcionet në valuta tjera përveç euros nëse ka pasur janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transakcioneve.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimëve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të ardhurave dhe të shpenzimeve. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, janë shpalosur në Shënimin 4 (I)

3. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(j) Hipoteza e vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi supozimin se kompania do të përmbushë hipotezën e vijimësisë, e cila supozon se Kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe të përmbushë detyrimet e saj në operacionet normale të biznesit. Kompania raportoi humbje operative për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 në shumën 2,961,713 euro dhe nga ajo datë humbjet e akumuluarra të Kompanisë janë në shumën 56,340,835 euro. Këto kushte tregojnë një pasiguri materiale, e cila mund të hedh dyshime të mëdha në aftësinë e Kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijimësisë.

Aftësia e kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijimësisë varet nga realizimi i objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin tre vjeçar të Biznesit të Kompanisë 2019 – 2022. Menaxhmenti beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të Kompanisë në rrethanat aktuale. Menaxhmenti nuk ka qëllim ose nevojë të likuidojë ose kufizojë materialisht fushën e operacioneve të tij në të ardhmen.

Kompania ka aprovuar planin tre vjeçar 2019-2022, ku qëllimet dhe objektivat e Kompanisë u prezantuan në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e pasurive dhe rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve që do të siguronin rritjen e të ardhurave gjatë tre viteve të ardhshme.

Menaxhmenti konsideron se nuk ka paqartësi materiale në lidhje me vazhdimësinë e Kompanisë. Humbja e akumuluar rezulton nga shpenzimi vjetor i zhvlerësimit. Flukset e parasë janë vërejtur dhe është analizuar që flukset hyrëse / dalëse të parave janë në raportin e dëshiruar që kompania të ruajë likuiditetin e saj, pavarësisht se për sa i përket fluksit të parave, shpenzimi i zhvlerësimit është zë jo-monetar. Fitimi para zhvlerësimit, tatimit dhe intersit është zvogëluar krahasuar me periudhën e mëparshme (ulje 42%). Kompania ka përmirësuar operacionet dhe rezultatet gjatë periudhave të fundit, që është dëshmi e mjaftueshme që linja e pjesëmarrjes është përmbushur nga menaxhmenti i Kompanisë.

Këto pasqyra financiare nuk përfshijnë ndonjë rregullim dhe riklasifikim që do të ishte i nevojshëm në rast se ky supozim nuk do të ishte vlefshëm.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

a. Prona, Impiantet dhe Pajisjet

Zërat e pronave, impianteve dhe pajisjeve ekzistuese që nga 1 Janari 2007 mbahen në rivlerësim bazuar në vlerësimin e bërë nga vlerësuesit e pavarur, zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar të mëpasshëm. Efekti i rivlerësimit merret në llogarinë e kapitalit. Të gjitha pronat, impiantet dhe pajisjet e tjera deklarohen me kosto minus zhvlerësim të akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me pasurinë do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato janë bërë.

Toka nuk është zhvlerësuar. Zhvlerësimi për pasuritë tjera llogaritet duke përdorur metodën e drejtëvizore për të shpërndarë koston e tyre ose shumat e rivlerësuar në vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar, si më poshtë:

#	Përshkrimi i llojit të pasurisë	Viti 2021	Viti 2020	Ligji: Nr.03/L-113
				Admin.talimore.
				Viti 2011
1	Objektet ndërtimore	1% - 2%	1% - 2%	5%
2	Makineritë e rënda	5% - 15%	5% - 15%	10%
3	Automjetet	5% - 20%	5% - 20%	20%
4	Pajisje të zyrës dhe kompjuterike	10% - 20%	10% - 20%	20%

Vlera e reziduale dhe jetëgjatësia e pasurive rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë të bilancit. Vlera kontabël e një pasurie shënohet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se vlera e parashikuar e rikuperueshme. Fitimet dhe humbjet nga heqjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave

b. Dëmtimi i pasurive jo-financiare

Pasuritë që kanë një jetë të papërcaktuar të dobishme nuk i nënshtrohen amortizimit dhe testohen çdo vit për dëmtim.

Pasuritë që i nënshtrohen amortizimit shqyrtohen për dëmtim sa herë që ngjarje ose ndryshime në rrethana tregojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Një humbje nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme të saj. Shuma e rikuperueshme është më e larta e vlerës së drejtë të një pasurisë më pak se kosto për të shitur dhe vlerën në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, pasuritë grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë flukse monetare të identifikueshme veç e veç (njësi gjeneruese të parave). Pasuritë jo-financiare që kanë pësuar dëmtim janë rishikuar për kthimin e mundshëm të dëmtimit në çdo datë raportimi.

c. Stoqet

Stoqet vlerësohen sipas koston më të ulët ose vlerës neto të realizuar, dhe raportohen jo më shumë se shumta e pritur të realizohet nga shitja ose përdorimi. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus kostot e vlerësuar të nevojshme për ta kryer shitjen. Kur kostoja e një artikulli të stoqeve e tejkalon vlerën neto të realizueshme, ky

tejkalim do të evidentohet si humbje në pasqyrën e të ardhurave. Kostoja e stoqeve është e përcaktuar në bazë të formulës "I pari Brenda - I pari jashtë" apo FIFO që nënkupton se ndërmarrja stoqet e biera me çmimin e parë i trajton dalje të parave.

d. Instrumentet Financiare

Njohja dhe ç'regjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare skadojnë, ose kur pasuria financiare edhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një material të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për shpenzimet e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Pasuritë financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Në peridhurat e prezentuara Kompania nuk ka ndonjë pasuri të kategorizuar si FVTPL dhe FVOCI.

Klasifikimi përcaktohet nga dy:

- modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare që njihen në fitim ose humbje janë paraqitur brenda kostove financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjera financiare, me përjashtim të dëmtimit të të arkëtueshmeve tregtare që paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të saj
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja është lënë jashtë ku efekti i zbritjes është jomaterial. Paraja e gatshme dhe ekulivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare shumica e të arkëtueshmeve të tjera bien në këtë kategori të instrumenteve financiare

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPPH)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga " të mbajtura për tu arkëtuar" ose "mbajtja për tu arkëtuar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga asetet financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në FVTPL.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI)
Kompania llogarit pasuritë financiare në FVTPL nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, qëllimi i të cilit është "të mbajtura për tu arkëtuar" e parave të lidhura dhe shitjes
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas ç'regjistrimit të pasurisë.

Dëmtimi i pasurive financiarë

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditorëve - 'modelin e humbjes së pritshme kreditorëve (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshijnë kreditë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e kontraktuara të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve kreditorëve nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditorëve. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut kreditor dhe matjes së humbjeve të pritshme kreditorëve, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit. Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një ndarje midis

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi njohjes ose që kanë rrezik të ulët kreditor ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kreditorit i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' do të mbulonte pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve kreditorëve gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

e. Kompensimi i instrumenteve financiare

Pasuritë dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar ku ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura dhe ekziston një qëllim për të shlyer në bazë neto ose për të realizuar pasuritë dhe për të shlyer detyrimin njëkohësisht.

f. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme shprehen në vlerat e tyre të drejta, me zbritje të lejuara dhe lejime për dëmtim dhe të matura me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Një lejimi për dëmtim e llogarive të arkëtueshme përcaktohet kur ekzistojnë prova objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e përcaktuara sipas kushteve origjinale të arkëtimit. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe parazgjedhja ose delikuenca në pagesa konsiderohen tregues se e arkëtueshmja është dëmtuar. Lejimi për dëmtim bëhet në bazë të vjetërsisë së balancave të arkëtueshme dhe përvojës historike, dhe kur mbledhja e pjesshme ose e plotë e një llogarie të arkëtueshme konsiderohet të mos jetë më e mundshme. Vlera kontabël e pasurisë zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie lejimi, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kur një e arkëtueshme është e paarkëtueshme, ajo zbritet kundër llogarisë së lejimit të llogarive të arkëtueshme. Rikuperimet pasuese të shumave të shkruara më parë dhe kthimi i humbjes nga dëmtimi i njohur më parë, janë të ardhura të kredituara në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

g. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë e gatshme në llogaritë rrjedhëse të mbajtura në banka, paratë në dorë dhe çdo investim tjetër me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muaj ose më pak që janë lehtësisht të konvertueshme në shuma të njohura të parave të gatshme, dhe i nënshtrohen një rreziku të ulët të ndryshimeve në vlerë..

h. Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë huazime dhe detyrime të tjera.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, dhe, kur është e përshtatshme, rregullohen për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania cakton një detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç për derivatet dhe detyrimet financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat barten më pas në vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha tarifatat që lidhen me interesin dhe, nëse është e aplikueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje, përfshihen në kostot e financimit ose të ardhurat nga financat.

Metoda efektive e interesit është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të shpërndarjes së shpenzimeve të interesit për periudhën përkatëse.

Norma efektive e interesit është ajo normë që zbrit saktësisht pagesat e parave të gatshme (përfshirë të gjitha tarifatat dhe pikat e paguara ose të pranuar që përbëjnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (kur është e përshtatshme) një periudhë më e shkurtër, në vlerën kontabël neto të njohjes fillestare.

I. Llogaritë e Pagueshme dhe detyrimet e tjera
Llogaritë e Pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

J. Huamarrjet
Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto të shpenzimeve të transaksionit të bëra. Huamarrjet mbarten më pas me koston e tyre të amortizuar; çdo ndryshim midis të ardhurave (neto i kostove të transaksionit) dhe vlera e shlyerjes njihet në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse gjatë periudhës së huazimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tarifat e paguara për krijimin e lehtësirave të kredisë njihen si koston e transaksionit të kredisë në atë masë sa kanë ndodhur ose deri në fshirje të tërësishe. Në këtë rast, njihet si tarifë e shtyrë derisa të ndodhë fshirja. Në atë masë sa nuk ka prova që ka të ngjarë që disa ose të gjitha nga tarifat të fshihen, tarifa kapitalizohet si parapagim për shërbimet e likuiditetit dhe amortizohet gjatë periudhës së objektit me të cilin ka të bëjë.

Huamarrjet klasifikohen si detyrime rrjedhëse, përveç nëse Kompania ka të drejtë të pakushtëzuar të shtyje shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar.

k. Kostot e huamarrjes
Kostot e përgjithshme dhe specifike të huamarrjes që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të aseteve kualifikuese, të cilat janë asete që domosdoshmërisht marrin një periudhë të konsiderueshme kohore për t'u përgatitur për përdorimin ose shitjen e synuar të tyre, i shtohen koston së atyre aktiveve, deri në atë kohë kur aktivet janë të gatshme për përdorimin ose shitjen e synuar të tyre. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

I. Grantet qeveritare
Një grant qeveritar njihet vetëm kur ekziston një siguri e arsyeshme që do të përmbushë kushtet e bashkangjitura me grantin dhe do të merret. Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës së nevojshme për t'i përputhur ato me koston e lidhura, për të cilat ato synojnë t'i kompensojnë, në mënyrë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, ai duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësim. Kur granti origjinal në lidhje me të ardhurat, ripagimi duhet të aplikohet së pari kundër çdo kredie të shtyrë të pandryshuar të lidhur, dhe çdo tepriçë duhet të trajtohet si shpenzim. Kur granti origjinal është në lidhje me një pasuri, ripagimi duhet të trajtohet si rritja e vlerës kontabël të pasurisë ose zvogëlimi i bilancit të të ardhurave të shtyra. Zhvlerësimi kumulativ i cili do të ishte ngarkuar nëse nuk merret granti duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për koston e bëra tashmë ose për ndihmë të menjëhershme financiare, pa kosto të lidhura në të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën është e arkëtueshme. Përfitimi i një granti me një normë të ulët interesi në treg trajtohet si një grant qeveritar i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerave të drejta të kredisë bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

m. Kapitali aksionar, rezervat, fitimet e mbajtura / akumuluar (humbjet)
Kapitali aksionar

Kapitali i aksioneve përbëhet nga vlera e drejtë e konsideratës monetare të kontribuar nga aksionarët.

Rezervat

Rezervat tërësisht përbëhen nga teprica e rivlerësimit, i cili fillimisht krijohet në datën e rivlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë, duke qenë ndryshimi midis rivlerësimit dhe kostos fillestare të pasurive.

Teprica e rivlerësimit të përfshirë në kapitalin e vet mund të transferohet drejtpërdrejt në fitimet e mbajtura kur teprica është realizuar. E gjithë teprica mund të realizohet në zhvlerësimin e plotë ose fshirjen e asetit. Sidoqoftë, disa prej tepricave mund të realizohen pasi asetit përdoret nga ndërmarrja; në një rast të tillë, shumën e tepricës së realizuar është ndryshimi midis zhvlerësimit bazuar në vlerën kontabël të rivlerësuar të asetit dhe zhvlerësimit bazuar në koston fillestare të asetit. Kalimi nga teprica e rivlerësimit në fitimet e mbajtura nuk bëhet përmes pasqyrës së të ardhurave.

Fitimi i mbajtur / (humbja) e akumuluar

Fitimet e mbajtura / (humbjet) e akumuluar përbëhen nga fitimet jo të shpërndara / humbjet e pambuluara nga periudhat aktuale dhe të kaluara.

n. Tatimi mbi fitimin aktual dhe të shtyrë

Shpenzimi tatimor për periudhën është shumën e tatimit mbi fitimin aktual dhe të shtyrë.

Ngarkesa e tanishme e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjit tatimor të miratuar në datën e bilancit.

Tatimi i shtyrë sigurohet në mënyrë të plotë, duke përdorur metodën e detyrimit, mbi ndryshimet e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të pasurive dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël të tyre në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur shkallën e tatimit e cila është miratuar në datën e bilancit dhe pritet të zbatohet kur asetit i lidhur me tatimin mbi fitimin e shtyrë është realizuar ose është shlyer detyrimi i tatimit të shtyrë.

Pasuria tatimore e shtyrë njihet vetëm në atë masë sa është e mundshme që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, kundër të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Asetet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor i lidhur dhe detyrimi tatimor respektivisht, të realizohen. Taksat shtesë të të ardhurave që vijnë nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendin e lidhur.

Kompania nuk ka njohur ndonjë detyrim ose pasuri tatimore të shtyrë në datat e raportimit.

o. Perfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Kompania paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur arrijnë moshën për pension. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Kompanisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Pagesa e pushimit vjetor

Kompania njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuar në lidhje me pushimet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

Kontributi shtesë për punonjësit

Ndërmarrja duke u bazuar në moshën mesatare të të punësuarve, kontributin e tyre në ndërmarrje, procedurave aktuale të pensionimit, përveç kontributit pensional të obligueshëm sipas legjislacionit në fuqi ka vendosur politika të ndarjes së kontributeve shtesë për të punësuarit. Këto kontribute shtesë i

ngarkojnë shpenzimet e pagave në pasqyrat e të ardhurave sipas periudhave kohore kur ndodhin. Që nga muaji Mars 2010, Ndërmarrja ka ndërprerë pagesën e kontributit shtesë për të punësuarit.

p. Provizionimet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe ka të ngjarë që do të kërkohej një rrjedhje e burimeve që sjellin përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrim. Provizionet rishikohen në çdo pasqyrë të datës së pozicionit financiar dhe rregullohen për të pasqyruar vlerësimin aktual më të mirë. Kur efekti i vlerës kohore të parasë është material, shuma e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohej për shlyerjen e detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme të operimit.

q. Njohja e të hyrave

Të hyrat maten bazuar në vlerësimin e specifikuar në kontratat e klientit dhe përjashtojnë shumat e mbledhura në emër të palëve të treta. Kompania njeh të ardhura kur transferon kontrollin mbi produktin ose shërbimin të klientit

Me qëllim të njohjes së të hyrave, kompania ndjek procesin sipas 5 hapave:

1. Identifikimi i kontratës me konsumatorin
2. Identifikimi i obligimeve të performancës
3. Përcaktimi i çmimit të transaksionit
4. Shpërndarja e çmimit të transaksionit në obligime të performancës
5. Njohja e të hyrave kur përmbushen obligimet e performancës.

Të hyrat njihen ose në një moment në kohë ose brenda një periudhe të caktuar atëherë kur kompania përmindshë obligimet e performancë duke transferruar mallrat ose shërbimet e premtuara.

Shitja e mallrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihet në një moment në kohë atëherë kur konsumatori përfiton kontrollin mbi mallrat, që zakonisht është në momentin e dërgesës.

Të hyrat tjera

Të hyrat tjera njihen kur pranohen ose kur e drejta për të pranuar pagesë është përcaktuar.

r. Njohja e shpenzimeve

Njohja e shpenzimeve bëhet vetëm kur pasuritë ekonomike të ndërmarrjes të shoqëruara me transaksione konsumohen për prodhimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave vetëm kur ato ndodhin sipas parimit aktual të kontabilitetit.

s. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare njihen mbi bazën e proporcionit në kohë që pasqyron rendimentin efektiv të aseteve. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huazimet dhe shpenzimet e paracaktuara të interesit për pagesa të vonuara. Kostot e huamarrjes njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv

t. Detyrimet kontigjente dhe zotimet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen nëse nuk është e largët mundësia e një rrjedhje burimesh që sjellin përfitime ekonomike. Një aset i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një rritje e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e një humbjeje kontigjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim i bërë si në pasqyrën e datës së pozicionit financiar dhe një vlerësim të arsyeshëm të shumës së humbjes që rezulton.

u. Përcaktimi vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parave të gatshme, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël për shkak të jetëgjatësisë së tyre afatshkurtër.

v. Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përcaktohen si ato palë që kanë kontroll mbi njëra-tjetrën ose kanë një ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra-tjetrës. Për qëllime të zbulimit të pasqyrave financiare, aksionarët e Kompanisë dhe subjektet e tyre të lidhur konsiderohen palë të lidhura.

w. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas fundvitit që japin informacion shtesë në lidhje me pozicionin e një kompanie në pasqyrën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) pasqyrohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas fundvitit që nuk rregullohen, shpalesen në shënime kur vlera është materiale.

x. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme për të cilat besohet se janë të arsyeshme në rrethanat e krijuara. Kompania bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit që rezultojnë, jo domosdoshmërisht do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale të lidhura. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerës kontabël të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë adresuar më poshtë;

Jetëgjatësia e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në Shënimin 4 (a) më lart, Kompania rishikon jetën e vlefshme të dobishme të pasurisë dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose faktor tjetër mund të ndikojë në jetën e dobishme të pasurive dhe, në përputhje me rrethanat, mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të atyre pasurive.

Provizioni për dëmtim të arkëtueshmeve dhe shlyerja e inventarit

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për rikuperimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe inventarëve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion të duhur për dëmtimin e të arkëtueshmeve dhe regjistron inventarët. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Tatimet

Shpenzimi i tatimit i kompanisë për aktivitetet e zakonshme është shuma e totalit të ngarkesave tatimore aktuale dhe të shtyra. Llogaritja e taksës totale të Kompanisë përfshin domosdoshmërisht një shkallë vlerësimi dhe gjykimi në lidhje me disa pika, trajtimi tatimor i të cilave nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa të arrihet zgjidhja me autoritetin përkatës tatimor ose, sipas rastit, përmes një procesi zyrtar ligjor. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të krijojë pasqyrë materiale të të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave të rrjedhës së parasë

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Faktorët e riskut financiar

Aktivitetet e kompanisë e vënë atë në një shumëllojshmëri të riskut financiar, duke përfshirë riskun e tregut, riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Menaxhimi i riskut të kompanisë përqëndrohet në parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon që të minimizoj efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të kompanisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Menaxhmenti i Kompanisë të bazuar në disa politika dhe procedura paraprakisht të aprovuara me shkrim që mbulon plotësisht menaxhimin e riskut, si edhe zona të veçanta, të tilla si risku i këmbimit valutor, riskut i normës së interesit, risku i kredisë, përdorimit të letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimit përtej likuiditetit.

Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë ose vlerën tujve të instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, derisa optimizon kthimin.

Risku i monedhës

Në përgjithësi, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi që shumica e shitjeve të saj, blerjeve dhe huazimeve janë në valutën Euro.

Risku i kreditor

Risku kreditor është risk në humbjen financiare të kompanisë, nëse një klient ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij të kontraktuara, dhe lirin kryesisht nga të arkëtueshme të kompanisë prej klientëve dhe investimeve në letra me vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është i ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Ky ekspozim mund të varet nga risku i mos pagesës në industri dhe tregun e brendshëm në të cilën vepron Kompania.

Kompania krijon një lejim për dëmtimet që pasqyrojnë vlerësimet e saj të humbjeve të shkaktuara në lidhje me të arkëtueshmet tregtare, të arkëtueshmet tjera dhe investimet. Komponentët kryesorë të këtyre lejimeve janë komponentë të veçantë të humbjes që ka të bëjë me ekspozimet individuale të rëndësishme, dhe një komponentë e përbashkët e humbjes e themeluar për asetet të ngjashme të kompanisë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur, por ende të pa identifikuar. Lejimi për humbjet e përbashkëta është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për asete të ngjashme financiare.

Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

Me 31 dhjetor	2021	2020
Pasuritë qarkulluese		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3,990,631	3,277,121
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	1,540,546	1,805,935
Pasuritë tjera afatshkurtëra Parapagimet	590,821	547,649
Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor	6,121,998	5,630,704

Riskut kreditor për para dhe ekuivalentët e parasë konsiderohet i papërfillshëm, pasi që bashkëpuntoret janë bankat me reputacion të lartë.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(Vlerat e shprehura në euro)

Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parave nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vërtetim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë.

Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vërtetim.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, detyrimet e kompanisë kishin maturitet të kontraktuar (duke përfshirë pagesat e interesit, ku është e aplikueshme) të përmbledhur si më poshtë:

Me 31 dhjetor	2021	2020
Detyrimet afatshkurtëra		
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	562,184	794,517
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	726,000	363,000
Tatimet e pagueshme aktuale	37,325	17,095
Të hyrat e shtyra nga përmbartimi	652	29,136
Të hyrat e shtyra nga donacionet	1,420,373	1,446,981
Perfitimet e punonjesve të pagueshme	23,632	23,132
Gjithsej detyrimet afatshkurtëra	2,770,166	2,673,861
Hendeku i likuiditetit	3,351,832	2,956,844

6. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

Më 31 dhjetor	2021	2020
Banka - BpB	903,919	720,911
Banka BKT	656,560	604,153
BKT W. B	2,922	
Banka TEB	1,911,363	1,357,268
Banka - Banka Ekonomike	490,015	127,601
Depozita - BpB	25,000	466,622
Arka e W. B	23	
Arka	830	565
Gjithsej	3,990,631	3,277,121

7. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE

Më 31 dhjetor	2021	2020
Shitja e energjisë elektrike – FETD	123,251	334,736
Shitja e Ujit industrial - Kosova B dhe A	74,999	268,052
Të arkëtueshmet nga ujitja	150,271	188,558
KUR, PRISHTINA, Prishtinë	12,932	14,267
Kompania, Ujesjellësi Regjional, Mitrovicë	832,590	658,532
NEËCO FERRONUKELI Complex LLC	44,474	36,644
KRU, MITROVICA, SH.A.-Vushtri	229,267	223,543
KUR, PRISHTINA, SH.A.-SHKABAJ	53,832	97,011
KOSTT	34,338	-
Llogaritë e arkëtueshme bruto	1,555,954	1,821,343
Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-15,408	-15,408
Llogaritë e arkëtueshme neto	1,540,546	1,805,935

Me 31 Dhjetor 2021 ne bilancin e përgjithshëm të llogarive të arkëtueshme vetëm nga klienti Ujesjellësi Regjional "Mitrovica" Sh.A. më 31 Dhjetor 2021 kërkesa arrin në 832,590 € (apo 54% e totalit të të arkëtueshmeve neto).

Ndërmarrja ka realizuar një Memorandum Bashkëpunimi mes tre palëve KRU "Mitrovica" Sh.A dhe NH "Ibër Lepenc" Sh.a dhe "Ministritë së Zhvillimit ekonomik". Qëllimi i këtij memorandumi është që palët kontraktuese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellët, me të cilin synohet: programimi i pagesave mujore, shmangie brenda mundësive të procedurave përmbarese për inkasim të borxhit si dhe angazhimi maksimal për shlyerje të borxhit paraprak të KRU " Mitrovica" Sh.A kundrejt kreditorit N.H "Ibër Lepenc" Sh.A.

8. STOQET

Gjendja e stoqeve është si në vijim:

	2021	2020
Me 31 dhjetor		
Material në depo	1,253,300	1,248,783
Inventari në depo	6,664	7,218
MHT në depo	3,675	3,977
Gjithsej	1,263,639	1,259,978
Lëvizjet e stoqeve gjatë vitit janë si në vijim:		
Me 31 dhjetor	2021	2020
Stoqet në fillim	1,259,978	1,167,545
Blerjet gjatë vitit	70,342	148,940
Shpenzimet për stoqet	-66,681	-56,507
Gjithsej	1,263,639	1,259,978

Stoqet me 31 dhjetor 2021 përbëhen nga pajsije hidrante, gypa për ujitje, mjete të punës, rrjeta të ujitjes, pjesë teknike për servis të stoqeve etj. Në ndërmarrje mbahen ekskluzivisht vetëm si pjesë rezervë për intervenime në objekte, mjete themelore dhe pajsje.

9. Pasurite tjera afatshkurtëra PARAPAGIMET

	2021	2020
Më 31 dhjetor		
Projekti: Sigurimi i ujit dhe mbrojtja e kanalit	86,410	86,410
Shpenzimet përmbarimit	6,816	9,630
Parapagimi i TVSH-së	470,206	429,501
Parapagimet tjera	27,389	22,108
Gjithsej	590,821	547,649

Parapagimet dhe kërkesat tjera afatshkurtëra paraqesin parapagimet e shpenzimeve nga Kompania.

10. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET				
Kosto me:	Objektet ndërtimore	Makineritë e rënda	Pajisjet dhe inventari	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2019/ 01 Janar 2020	280,315,589	4,166,384	7,688,423	292,170,395
Shtesat	72,843		88,677	161,520
Shitjet (heqjet)			-29,936	-29,936
Me 31 dhjetor 2020	280,388,432	4,166,384	7,747,164	292,301,979
Shtesat	192,266		150,371	342,637
Shitjet (heqjet)			-115,945	-115,945
Me 31 dhjetor 2021	280,580,698	4,166,384	7,781,590	292,528,671
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 01 Janar 2020	171,730,469	-2,988,797	7,487,880	182,207,146
Shpenzimi për periudhën (Heqje)/Korigjimi i zhvlerësimit	-4,473,336	-83,022	-61,708	-4,618,066
			29,882	29,882
Me 31 dhjetor 2020	176,203,805	-3,071,819	7,519,706	186,795,330
Shpenzimi për periudhën (Heqje)/Korigjimi i zhvlerësimit	-4,473,712	-83,022	-73,063	-4,629,797
			95,677	95,677
Me 31 dhjetor 2021	180,677,517	-3,154,841	7,497,092	191,329,450
Vlera neto në libra më 31.12.2020	104,184,627	1,094,565	227,458	105,506,650
Vlera neto në libra më 31.12.2021	99,903,181	1,011,543	284,498	101,199,222

Zërat që përbëjnë Pronën, Impiantet dhe Pajisjet paraqesin objektet ndërtimore, makineritë e rënda, pajisjet dhe inventarin. Pasuritë e blera para datës 01 Janar 2007 dhe që ekzistojnë më 31 Dhjetor 2021 mbahen me shumën e vlerësuar, duke zbritur shumën e zhvlerësimit të akumuluar. Të gjithë artikujt e tjerë mbahen me kosto duke zbritur shumën e zhvlerësimit të akumuluar.

11. Pasuri e paprekshme

Me 31 Dhjetor	2021
Shtesat	29,449
Shitjet (heqjet)	0
Me 31 dhjetor 2021	29,449

Gjatë vitit 2021 Kompania ka blerë softuerin për financa, kontabilitet dhe burime njerëzore "Navision" në vlerë 29,449€.

12. INVESTIMET NËN PROJEKTIN "Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit"

Më 27 Janar 2017 Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave (MF) - pranuesi dhe Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit - Banka Botërore - Huadhënësi, hyri në marrëveshje financimi IDA Credit 5902 - XK), për të financuar Projektin Siguria për Ujin e Kosovës dhe Mbrojtjes së Kanalit ("Projekti"). Projekti zbatohet nga Iber-Lepenc ("I-L") dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Me shumë detaje në lidhje me marrëveshjen financiare janë shpalosur në Shënimin 19 më poshtë.

Në bazë të marrëveshjes së huasë, Iber-Lepenc ka krijuar një Njësi të Koordinimit të Projektit (PCU) me funksione, staf dhe burime të kënaqshme për Shoqatën me qëllim të sigurimit të koordinimit të shpejtë dhe efikas të përgjithshëm, zbatimit të përditshëm dhe komunikimit në lidhje me aktivitetet dhe rezultatet e projektit.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në rivendosjen e Kanalit Ibër në kapacitetin e tij origjinal për të përmirësuar menaxhimin e burimeve ujore për përdoruesit e ndryshëm të ujit të kanalit në Kosovën Qendrore. Investimet e projektit paraqesin shpenzime të kapitalizuara të bëra për blerje të mallrave, punëve, shërbimeve jo-këshilluese, shërbimet e këshilltarëve dhe kostove inkrementale operative.

Lëvizja e llogarisë së investimit të projektit për periudhat e raportuara është si më poshtë:

	Kosto	Zhvlerësimi i Akumuluar	Vlera Neto
Me 01 Janar 2020	199,989	-4,933	195,056
Shtesat	2,533,597	-	2,533,597
Shitjet (heqjet)	-	-2,369	-2,369
Me 31 dhjetor 2020	2,733,586	-7,302	2,726,284
Shtesat	791,518	-	791,518
Shitjet (heqjet)	-	-3,158	-3,158
Me 31 dhjetor 2021	3,525,104	-10,460	3,514,644

13. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE

	2021	2020
Me 31 dhjetor		
KEK-DISPEQING PISHTINA	4,007	3,402
DISPEQING MITROVICA	14,761	14,208
PTK-PRISHTINË	1,124	1,145
Ministria e planifikimit hapësinor (MMPH)	385,476	722,246
Furnitorë tjerë	156,816	53,517
Gjithsej	662,184	794,518

14. KREDITË DHE HUATË, PJESA AFATSHKURTËR

	2021	2020
Me 31 dhjetor		
Pjesa e detyrimit ndaj bankës për periudhen 1 vjeçare	726,000	363,000
Gjithsej	726,000	363,000

15. TATIMET E PAGUESHME AKTUALE

	2021	2020
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor		
Tatimi në paga dhe meditje	37,325	17,095
Tatimi në interes		
Gjithsej	37,325	17,095

16. TË HYRAT E SHTYERA NGA PËRMBARIMI

	2021	2020
Më 31 dhjetor		
Të hyrat e shtyera	652	29,136
Gjithsej	652	29,136

17. TË HYRAT E SHTYERA NGA DONACIONET

Emërtimi	Bilanci 2019	Grantet 2020	Shpenzimet 2020	Bilanci 2020
Pajisje - themelore	1,189,280		-24,653	1,164,627
Materiali	282,590		-236	282,354
Gjithsej	1,471,870	0	-24,889	1,446,981

Emërtimi	Bilanci 2021	Grantet 2021	Shpenzimet 2021	Bilanci 2021
Pajisje - themelore	1,164,627		-24,653	1,139,974

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
 (Vlerat e shprehura në euro)

Materiali	282,354		-1955	280,399
Gjithsej	1,446,981	0	-26,608	1,420,373

Grantet nga projekti me BE-në me 31 dhjetor 2019 janë në vlerë prej 1,471,870 euro. Gjatë vitit 2019 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, janë marrë grante në pajisje në vlerë 977,536 Euro dhe material 43,604 euro të cilat paraqesin pajisje dhe stoqe. Gjithsej grante të shpenzuara për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 janë në shumë prej 24,889 euro ndërsa për vitin 2021 janë shpenzuar gjithsej 26,608 euro.

18. PËRFITIMET E PUNONJËSVE -TË PAGUESHME

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2021	2020
Detyrimet ndaj pagave bonus	13	12
Detyrimet ndaj sindikatës	981	952
Meditjet e anëtarëve të Bordit		
Kontributet pensionale	22,638	22,168
Gjithsej	23,632	23,132

19. KREDITË DHE HUATË, PJESA AFATGJATË

Në huamarrjet më 31 Dhjetor 2021, shuma prej 3,249,712€ ka të bëjë me kredinë e dhënë ndaj Kompanisë bazuar në marrëveshjen financiare IDA Credit 5902 - XK) të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave (MF) - Pranuesi dhe International Development Association- Banka Botërore - Huadhënësi. Palët kontraktuese hynë në marrëveshjen e financimit për të financuar Projektin për Sigurinë e Ujit dhe Kanalin e Mbrojtjes të Kosovës ("Projekti"). Më shumë detaje janë dhënë në Shënimin 12 më lart.

Bilanci i huamarrjeve më 31 Dhjetor 2021 paraqet disa këste të gjithsej 22 milion EUR. Qeveria e Kosovës do të paguajë shumën kryesore të Kredisë në këste gjysmë-vjetore, në secilin 15 Prill dhe 15 Tetor, si vijon:

Huamarrjet afatgjata që bartin interes	2021	2020
IDA- Banka Botërore (22 milion euro)	3,249,712	3,378,969
	726,000	363,000
Pjesa e detyrimit ndaj bankës për periudhen 1 vjecare		
Gjithsej	3,975,712	3,741,969
Data e pagesës	Shuma e Principallit të pagueshëm si përqindje	

Duke filluar nga 15 tetori 2021, deri dhe duke përfshirë, 15 Prill 2031	Duke filluar nga 15 Prilli 2031, deri dhe duke përfshirë, 15 Prill 2041.	1.65%
		3.35%

20. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionari i kompanisë i prezentuar në pasqyrën e ndryshimeve të ekuitetit ka vlerën 25,000 Euro. Qeveria e Republikës së Kosovës posedon 100% të aksioneve të kompanisë.

21. TË HYRAT NGA AKTIVITETET

Për viti që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike	3,666,414	2,190,239
Të hyrat nga shitja e ujit industrial	2,090,556	2,121,975
Të hyrat nga ujitja	105,972	102,530
Të hyrat nga Jobalanca për HC Ujman	384,180	76,960
Gjithsej të hyrat nga aktivitetet operative (I)	6,247,122	4,491,704

22. TË HYRAT TJERA

Për viti që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Të hyrat nga kamata (përmbaruesi)	92,431	36,494
Të hyrat nga donacionet	26,608	24,889
Të hyrat nga ndalesat e punëtorëve		
Të hyrat nga interesi (vonesat)	7	493
Të hyrat tjera	5,922	26,421
Gjithsej të hyrat tjera (II)	124,968	88,297
Gjithsej të hyrat (I+II)	6,372,090	4,580,001

23. SHPENZIMET E PERSONELIT

Për viti që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Pagat e rregulta	2,497,443	2,472,400
Pagat jashte orarit	45,781	49,152
Paga Jubilare	255,692	0
Pushimet mjekësore	0	22,313
Pagat përcjellëse	41,130	28,248
Kompenzimet e veçanta (Shujta)	130,542	117,682
Sindikata	13,435	11,722
Tatimi në paga	234,960	200,284
Kontributi pensionale	337,506	301,988
Shpenzimet e bordit, taksa kontribute etj	15,377	34,038
Gjithsej	3,571,866	3,237,827

24. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Udhëtime, medijtje, transport etj	1,473	0
Provizionet Bankare	887	0
Shpenzimet Komunale	12,461	12,072
Shpenzimet e telekomunikimit	9,825	11,150
Artikuj te përbashket, materiale për zyre dhe direkte	0	35,482
Shpenzimet e reprezentacionit	9,436	7,381
Shpenzimet per sherbime	1,493	1,269
Sigurimi Shendetsor	94,483	
Shpenzimet tjera të përbashkëta (Auditimi PFV 2020)	3,220	138,744
Gjithsej	133,278	206,098

25. SHPENZIMET OPERATIVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve	30,387	24,205
Shpenzimet e servisimit dhe kontrollit (AKZ)	850	810
Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve	12,991	11,001
Material Hargjues	65,522	2,318
Provizionet bankare	0	15,236
Shpenzimet e derivateve	34,907	33,336
Kompensimi i Dëmeve	6,608	
Shpenimzet nga jobalanca HC UJMAN	43,235	53,091
Shpenzimet e energjisë elektrike	274,233	257,447
Gjithsej	468,733	397,444

26. SHPENZIMET E TAKSAVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Taksa per rregullatore dhe MMPH	362,823	238,929
Shpenzimet e kamatës dhe ndëshkimeve	110,705	
Tatimi në pronë	2,953	2,516
Gjithsej	476,481	241,445

27. SHPENZIMET E INTERESIT

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2021	2020
Shpenzimet e interesit	50,490	0
Gjithsej	50,490	0

28. DETYRIMET KONTIGJENTE DHE ZOTIMET

Çështjet gjyqësore

Në 31 Dhjetor 2021, procedurat ligjore të ngritura kundër Kompanisë janë në shumë prej 699,326.43€. Për më tepër, veprime të ndryshme ligjore dhe pretendime mund të pohohen në të ardhmen kundër Kompanisë nga proceset gjyqësore dhe pretendimet në rrjedhën normale biznesore. Rreziqet e ndërlidhura janë analizuar për mundësinë e shfaqjes. Megjithëse rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të konstatohet gjithmonë me përpikëri, megjithatë menaxhmenti i Kompanisë beson që nuk ka detyrime materiale të cilat mund të ndodhin.

Vlera në Euro e çështjeve gjyqësore ku ndërmarrja është paditëse është: 18,090.18€. Ndërmarrja shumicen e lëndëve i ka në procedurë përmbartimore ku vlera kreditore është: 84,138.73€ nga të cilat 16,580.70€ janë paguar dhe pretendojmë të realizohet edhe vlera e mbetur 67,558.03€. Kjo vlerë ka të bëjë kryesisht me borxhe për ujitje.

NH Ibër Lepenc debitorin kryesor në procedurë përmbartimore e ka KRU "Mitrovica" për furnizim me ujë industrial të papërpunuar të cilën e ka të dërguar në procedurë përmbartimore për lëndët të cilat përfshijnë periudhën deri në Qershor 2021.

Vlera e kërkesës në tërësi në procedurë përmbartimore për lëndet aktive për KRU "Mitrovica" është 1,208,547.60€ prej të cilave janë paguar 305,931.46€ dhe pretendojmë të realizohen pagesat edhe në vlerën e mbetur 902,634.14€.

Detyrimet tatimore

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë janë inspektuar nga autoritetet tatimore për periudhën 01 janar 2015 – 31 dhjetor 2019. Prandaj obligimet tatimore të Kompanisë mund të konsiderohen si të përfunduara deri me 31 Dhjetor 2019. Tatimet shtesë që mund të lindin në rast të kontrollit tatimor nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme.

Zotimet

Për më tepër, nga ato të shpalosura tashmë në këto pasqyra financiare, më 31 dhjetor 2021 nuk ka zotime kontraktuale dhe / ose zotime tjera.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(Vlerat e shprehura në euro)

29. TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Palët e ndërlidhura përfshijnë kompaninë mëmë, ndërmarrjet e lidhura, Kompanitë e tjera të grupit të lidhur, drejtorët e kompanisë dhe personelin kryesor të menaxhmentit. Kompania në rrjedhën normale të biznesit kryen transaksione me palë të ndryshme të lidhura.
 Të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura janë realizuar në kushte dhe kushte tregtare.

31 dhjetor 2021	Të arkëtueshmet	Të pagueshmet	Grantet e shtyera	Të hyrat	Shpenzime
Qeveria e Kosovës dhe donatorë tjerë		385,476	1,439,730	26,608	0
Kompenzimi i menaxhmentit të lartë					111,062
Anëtarët e Bordit					15,377
Gjithsej	-	385,476	1,439,730	26,608	126,439

31 dhjetor 2020	Të arkëtueshmet	Të pagueshmet	Grantet e shtyera	Të hyrat	Shpenzime
Qeveria e Kosovës dhe donatorë tjerë		722,246	1,446,981	24,889	202,952
Kompenzimi i menaxhmentit të lartë					108,047
Anëtarët e Bordit					34,038
Gjithsej	-	722,246	1,446,981	24,889	345,037

30. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas 31 Dhjetorit 2021 dhe deri në nxjerrjen e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje të tjera që do të kishin nevojë për shpalosje ose korrigjime në këto pasqyra financiare.